

EU Policy Hub është një forum i profesionistëve të rinj i cili synon të promovojnë, të monitorojnë dhe të ndikojë në performancën e procesit të Integrimit Evropian të Shqipërisë

WWW.EUPOLICYHUB.EU

# ‘GARA ME PENGESA’ DREJT ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

*A është Shqipëria në  
grupin e vendeve me  
anëtarësim të  
ngadaltë dhe pse?*



## ‘GARA ME PENGESA’ DREJT ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

*A është Shqipëria në grupin e vendeve me anëtarësim të ngadaltë dhe pse?*

Dr. Dorian Jano

EU Policy Hub

### Abstrakt

Në këtë dokument politikash ne vlerësojmë ecurinë e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE, si në aspektin e marrëdhënieve institucionale ashtu edhe në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardeve evropiane. Nga analiza e këtij dokumenti politikash vërejmë se ecuria e Shqipërisë drejt anëtarësimit është jo vetëm e avashtë por edhe e çalë, kjo kryesisht për shkak të polarizimit politik dhe kapaciteteve të mangëta administrative.

### Tabela e Përmbajtjes

HYRJE: ‘GARA ME PENGESA’ DREJT ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN	2
‘ME HAPIN E BRESHKËS’: ECURIA E MARRËDHËNIE KONTRAKTUALE NË FAZAT E NDRYSHME TË ANËTARËSIMIT NË BE	4
ARSYET E VONIMIT NË KOHË	6
PROGRES KONSTANT I ÇALË: PËRMBUSHJA E STANDARDEVE EVROPIAN	7
ARSYET E MOS AVANCIMIT ME REFORMAT PËR ANËTARËSIM	11
KONKLUSIONE	12

## HYRJE: ‘GARA ME PENGESA’ DREJT ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

Samiti i Zagrebit i vitit 2000 hodhi themelet e politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE) në Ballkanin Perëndimor (BP). Kjo politikë e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor, në ndryshim nga ‘Big-Bang-u’ i zgjerimit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL), ka si element kryesor anëtarësimin individual për secilin prej vendeve të Ballkanit Perëndimor. ‘Qasja e Individualizuar’<sup>1</sup> nënkupton anëtarësimin në BE sipas meritave individuale të progresit të arritur nga çdo vend kandidat. Qëllimi i kësaj qasjeje të individualizuar është stimulimi i konkurrencës konstruktive midis vendeve të rajonit si dhe identifikimi i praktikave më të mira.<sup>2</sup> Pas gati 20 vjet nga perspektiva evropiane, politika e zgjerimit nuk ka ndryshuar shumë, ajo është vazhdimi i qasjes graduale dhe të ngadaltë të anëtarësimit, bazuar në kushtëzimin e zgjeruar me fokus të madh në sundimin e ligjit dhe mekanizma shtesë monitorimi. Gjithsesi krijimi i një shumëllojshmërie kërkesash komplekse dhe fokusi tek prioritetet individuale të shteteve, e ka bërë anëtarësimin në BE një objektiv të lëvizshëm të pakapshëm ku vendet më problematike do të duhet të kapërcejnë pengesa më të mëdha për t’u bashkuar me BE-në. Sot, ‘gara’ për anëtarësim në BE është thelluar së tepërmi në varësi të ecurisë së çdo shteti, fakt i cili

<sup>1</sup> “Unioni propozon një qasje të individualizuar për secilin nga këto vende” (të Ballkanit Perëndimor) Shih: European Commission (2000) “Zagreb Summit Final Declaration, Zagreb.

<sup>2</sup> Marciacq, Florent (2015) “EU Enlargement in troubled times? Adapting to new realities and drawing lessons from democratisation failures”, ÖGfE Policy Brief 39, Vienna, fq. 4.

reflektohet në shkallën dhe llojin e marrëdhënieve kontraktuale me Bashkimin Evropian. Të gjitha vendet e rajonit janë në etapa të ndryshme të integritimit evropian. Kroacia është i vetmi vend nga rajoni, i cili që nga korriku i vitit 2013 është shtet anëtar i BE-së. Ndërkohë, Mali i Zi dhe Serbia janë në negociata për anëtarësim, Maqedonia dhe Shqipëria janë vende kandidatë, kurse Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova janë akoma vende potencialisht kandidatë. Madje edhe brenda një modaliteti, vendet e Ballkanit Perëndimor paraqesin shpejtësi të ndryshme të avancimit në përmbushjen e standardeve evropiane.

Shqipëria bën pjesë në grupin e vendeve me anëtarësim të ngadaltë, pasi progresi në përmbushjen e kushteve të BE-së ka qenë i vështirë dhe më i gjatë, në krahasim me shumicën e vendeve të tjera të rajonit, pavarësisht se Shqipëria nuk u përfshi në konfliktet e dhunshme të ish-Jugosllavisë dhe nuk ka mosmarrëveshje politike thelbësore, si në rastin e Maqedonisë për çështjen e emrit, mosnjohja e Kosovës si shtet i pavarur nga 5 shtete anëtare të BE-së apo kriza e thellë politike dhe institucionale e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës. Skenarë të ndryshëm janë paraqitur nga studiues dhe ekspertë të ndryshëm rreth datave të mundshme të

anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Përpara 10 vitesh, ekspertët bazuar ekskluzivisht në analizën e faktorëve të brendshëm vlerësonin se në skenarin më të keq të mundshëm por i cili ishte më i mundshëm, Shqipëri nuk do të mund të jetë shtet anëtar përpara vitit 2020.<sup>3</sup> Një studim i fundit, i cili analizon kapacitetin vendore të shteteve kandidatë (kostot e adaptimit dhe kapacitetet administrative) për të përmbushur kriteret e anëtarësimit, gjen se Shqipëria do të përballlet me vështirësi në përmbushjen e kushteve të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së dhe parashikohet që vendi, ashtu si shtetet më problematike të Ballkanit Perëndimor, nuk do të mund të jetë shtet anëtar i BE-së përpara vitit 2050.<sup>4</sup>

Po ku qëndron realisht Shqipëria në garën e anëtarësimit për t'iu bashkuar BE-së krahasuar me vendet e tjera të rajonit, por edhe në kohë? Sa kohë i është dashur vendit për kapërcimin e etapave të ndryshme të procesit të integritimit, si dhe cili është niveli i përafrimit me standardet evropiane? Cilat janë shkaqet kryesore të cilat influencojnë në performancën e Shqipërisë dhe si mund të nxirren mësim për të përmirësuar procesin? Këto janë pyetjet të cilat do të adresojmë në këtë dokument politikash jo-periodik. Pavarësisht se për të vlerësuar situatën dhe faktorët që e influencojnë atë,

<sup>3</sup> Vurno, Gjergji (2008) "Relations of Albania with the EU", Paper prepared in the Framework of the Project: 'Integration Perspectives and Synergic Effects of European Transformation in the Countries Targeted by EU Enlargement and Neighborhood Policies', Center for EU Enlargement Studies, Budapest.

<sup>4</sup> Böhmelt, Tobias dhe Tina Freyburg (2017) "Forecasting candidate states' compliance with EU accession rules, 2017–2050", *Journal of European*

*Public Policy*. Analiza të tjera janë më optimiste përsa i përket kohës kur vendi do ti bashkohet BE-së, gjithsesi në lidhje me progresin e arritur, Shqipëria është më afër Bosnjë-Hercegovinës sesa vendeve si Mali i Zi dhe Serbia. Shih: Jay, Tom (2016) The race for EU membership: Enlargement is not high on the EU's agenda, but that isn't stopping its would-be members, *POLITICON*, Dhjetor.

përveç kushteve të vendit do të duhet të konsiderojmë edhe qasjen e BE-së ndaj politikës së zgjerimit apo zhvillimet brenda vetë BE-së dhe vendeve anëtarë, ne do të përqendrohemi kryesisht tek faktorët e brendshëm kjo edhe për faktin se analiza dhe vlerësimi i problematikës të politikës aktuale të zgjerimit në Ballkanin Perëndimor është kryer nga studime të tjera.<sup>5</sup>

#### **‘ME HAPIN E BRESHKËS’: ECURIA E MARRËDHËNIE KONTRAKTUALE NË FAZAT E NDRYSHME TË ANËTARËSIMIT NË BE**

Pas vonesave për shkak të paqëndrueshmërisë politike dhe vështirësive në zbatimin e reformave, negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me Shqipërinë u hapën zyrtarisht më 31 janar 2003 dhe përfunduan në qershor 2006, duke qenë kështu shteti i tretë i BP që nënshkruante MSA-në me BE. MSA-ja hyri në fuqi më 1 prill 2009 dhe në 28 prill 2009 Shqipëria paraqiti formalisht kërkesën e saj për anëtarësim në BE, pavarësisht thirrjeve dhe këmbënguljes së zyrtarëve të BE-së, përfshirë edhe Komisionerin për Zgjerim, që qeveria të mos paraqiste kërkesën përpara zgjedhjeve të përgjithshme të vendit, pasi përparimi i mëtejshëm drejt procesit të integritetit evropian do të varej nga zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.<sup>6</sup> Në opinionin e tij mbi aplikimin e Shqipërisë, Komisioni Evropian vlerësoi se përpara se

të hapeshin negociatat e anëtarësimit, vendi kishte ende punë për të bërë për të arritur një shkallë të mjaftueshme të pajtueshmërisë me kriteret e anëtarësimit. Për këtë Komisioni rekomandoi që negociatat të hapen pasi vendi të përmbushte 12 prioritetet kryesore të identifikuar në Opinionin e Komisionit.<sup>7</sup> Pas dy ‘jo-ve’ të njëpasnjëshme dhe të qarta në vitin 2010 dhe 2011, Komisioni Evropian rekomandoi në tetor 2012 statusin e kushtëzuar të vendit kandidat, me kusht që Shqipëria të përmbushte masat kyçe në fushën e drejtësisë, reformës në administratën publike, si dhe përfundimin e rishikimit të procedurave të rregullores parlamentare. Më 16 tetor 2013, Shqipërisë më në fund iu dha drita jeshile nga Komisioni Evropian për statusin e vendit kandidat, i cili vlerësoi rekomandimet si kryesisht të përmbushura. Këshilli Evropian e ka marrë parasysh këtë rekomandim të Komisionit Evropian dhe i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidatit në qershor 2014. Aktualisht hapja e negociatave për anëtarësim varet nga përparimi i mëtejshëm i Shqipërisë në pesë prioritetet kryesore, konkretisht reforma në administratën publike; forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së gjyqësorit, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar, dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Në raportin e fundit, në nëntor 2016, Komisioni Evropian rekomandoi që shtetet anëtare të marrin në

<sup>5</sup> Shih p.sh: Balkans in Europe Policy Advisory Group (2014) “The Unfulfilled Promise: Completing the Balkan Enlargement”, Policy Paper, Maj.

<sup>6</sup> Balkan Insight (2009) ‘EU Welcomes Albania's Application: European Commission has welcomed Albania's application for EU membership’. Prill.

<sup>7</sup> European Commission (2010) Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union, Brussels, 9.11. 2010, COM(2010) 680, fq.11-12.

konsideratë hapjen e negociatave për anëtarësim me Shqipërinë në rastin kur vlerësohet se progres i besueshëm dhe i prekshëm është arritur në zbatimin e

reformës në drejtësi të miratuar në korrik 2016, në veçanti rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i *vetting*-ut).<sup>8</sup>

**Tabela 1: Etapat e anëtarësimit dhe statusi i marrëdhënieve të BE-së me vendet e BP**

Statusi	Shteti	Fazat							
		Fillimi i Negociatave për MSA-në	Nënshkrimi i MSA-së	Hyrja në fuqi e MSA-së	Aplikimi për Anëtarësim	Marrja e statusit kandidat	Fillimi i negociatave për anëtarësim	Mbyllja e negociatave për anëtarësim	Anëtarësimi
Shtet Anëtar	Kroacia	Prill 2000	Tetor 2001	Shkurt 2005	Shkurt 2003	Qershor 2004	Tetor 2005	Qershor 2011	Korrik 2013
Shtet në negociatë	Mali i Zi	Shtator 2006	Tetor 2007	Maj 2010	Dhjetor 2008	Nëntor 2010	Qershor 2012	--	--
	Serbia	Tetor 2005	Prill 2008	Shtator 2013	Dhjetor 2009	Mars 2012	Janar 2014	--	--
Shtet Kandidat	Shqipëria	Janar 2003	Qershor 2006	Prill 2009	Prill 2009	Qershor 2014	--	--	--
	Maqedonia	Mars 2000	Prill 2001	Prill 2004	Mars 2004	Dhjetor 2005	--	--	--
Shtet Potencialisht Kandidat	Bosnja-Hercegovina	Janar 2006	Qershor 2008	Qershor 2015	Shkurt 2016	--	--	--	--
	Kosova	Tetor 2013	Tetor 2015	Prill 2016	--	--	--	--	--

Burimi: Komisioni Evropian.

Nga tabela e etapave të anëtarësimit dhe statusit të marrëdhënieve të BE-së me vendet e BP vërejmë se vendet të cilat janë avangarde në procesin e integritimit iu është dashur një kohë e shkurtër, rreth një vit, për kalimin nga një fazë e procesit në tjetrën. Ndërkohë, në rastin e Shqipërisë kalimi i fazave të procesit të anëtarësimit kërkon një kohë më të gjatë. Në rastin e negociatave

për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimin, procesi zgjati tre vjet e gjysmë, pothuajse tre herë më shumë se sa në rastin e Kroacisë, Maqedonisë, apo Malit të Zi. Për Kroacinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Maqedoninë<sup>9</sup>, koha nga aplikimi deri tek marrja e statusit vend kandidat dhe më pas në hapjen e negociatave ka qenë një deri në dy vjet, ndërkohë në rastin e Shqipërisë janë

<sup>8</sup> European Commission (2016) “2016 Enlargement Package: Credible enlargement process key to driving transformation and anchoring stability in Southeast Europe”, Press release, Bruksel, Nëntor.

<sup>9</sup> Në rastin e Maqedonisë, fillimi i negociatave për anëtarësim, midis të tjerave, është për shkak të mosmarrëveshjes me Greqinë për çështjen e emrit.

Dimitrova, Antoaneta L. (2016) The EU’s Evolving Enlargement Strategies: Does Tougher Conditionality Open the Door for Further Enlargement?, No. 30, Qershor, “Maximizing the integration capacity of the European Union: Lessons of and prospects for enlargement and beyond” (MAXCAP), fq. 13.

dashur 5 vjet për marrjen e statusit kandidat nga data e aplikimit formal. Sot, më shumë se 3 vjet kanë kaluar dhe negociatat për anëtarësim janë shtyrë dhe akoma nuk ka një datë se kur Shqipëria mund të fillojë bisedimet me BE-në. Nëse analizohet ecuria e marrëdhënie kontraktuale në fazat e ndryshme të anëtarësimit, Shqipëria qartazi duket se po ecën me një ritëm shumë më të avashtë se shumica e vendeve të tjera të rajonit, pavarësisht se ajo ishte në *'pole position'* në fillimet e viteve '90, si vendi i parë nga rajoni i cili nënshkroi në maj 1992 me Komunitetin e atëhershëm Evropian marrëveshjen e tregtisë dhe bashkëpunimit ekonomik.

#### ARSYET E VONIMIT NË KOHË

Shqipëria duhet të kishte qenë në grupin e vendeve që kanë avancuar drejt anëtarësimit, por për shkak të polarizimit të brendshëm politik ekstrem, vendi nuk duket ende i gatshëm që të mund t'i japë prioritet agjendës evropiane.<sup>10</sup> Ecuria e ngadaltë e marrëdhënie kontraktuale drejt anëtarësimit në BE ka qenë dhe vazhdon të jetë kryesisht për shkak të polarizimit politik ekstrem të vendit dhe mungesës së frymës bashkëpunuese.

Nëse i referohemi indeksit të Transformimit Bertelsmann (BTI), sistemi

partiak në Shqipëri është karakterizuar nga një nivel polarizimi të moderuar, i cili sa vjen edhe po thellohet.<sup>11</sup> Në Shqipëri, gjatë dhe pas zgjedhjeve, është vërejtur një polarizim i tensionuar politik, i cili karakterizohet nga një qasje konfliktuale, bojkote të vazhdueshëm, akuza të ndërsjellat, qëndrime antagoniste midis grupimeve politike, çka e ka bërë të vështirë ose pothuajse të pa mundur diskutimin dhe negocimin për çështjet primare të integritetit evropian të vendit, dhe për rrjedhojë është penguar në mënyrë të vazhdueshme përparimin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Kjo situatë shpesh herë është reflektuar edhe në komunikimet dhe raportet e Komisionit Evropian, të cilat vlerësojnë se në Shqipëri “polarizimi politik mbeti i lartë [...]” dhe si rezultat kjo ka “penguar dialogun politik dhe proceset teknike”.<sup>12</sup> Për më tepër, në një letër që presidenti i Komisionit Evropian Junker i drejton kryeministrit të Shqipërisë ka theksuar se “rruga drejt BE-së e vendit do të kërkojë me të vërtetë dialog konstruktiv dhe bashkëpunim të ndërsjellët ndërpartiak”.<sup>13</sup>

Në shumicën e rasteve opozita në Shqipëri, e çdo krahu politik, ka luajtur në mënyrë indirekte një rol frenues në avancimin e procesit të integritetit evropian

<sup>10</sup> “Executive Summary” në Jacques Rupnik ed. *The Western Balkans and the EU: 'the hour of Europe'*, Chaillot Paper, EU Institute for Security Studies, Paris, Qershor 2011, fq. 9

<sup>11</sup> Pika 5.1 për sistemin partiak vlerëson nëse ka një sistem partiak të qëndrueshëm në gjendje të artikulojnë dhe të përfaqësojë interesat shoqërore, duke pasur parasysh edhe nivelin e polarizimit. Një vlerësim më pak se 4 tregon polarizim të lartë, vlerësimi nga 4 deri në 7 tregon polarizimin të moderuar dhe një vlerësim më i lartë deri në 10 konsideron polarizimin të ulët të sistemit partiak. Sistemi Partiak në Shqipëri në vitin 2006 është

vlerësuar me 7 dhe më pas deri në vitin 2016 me 6, çka tregon rritje të polarizimit të sistemit partiak me 1 pikë. Shih: Të dhënat e BTI <https://www.bti-project.org/>

<sup>12</sup> European Commission (2016) Albania 2016 Report, Brussels, 9.11.2016, SWD(2016) 364 final, f.7.

<sup>13</sup> Letra që presidenti Juncker i dërgon kryeministrit të Shqipërisë Rama, datë 03.07.2017, në Oliphant, Vicki (2017) EU to replace Britain with ALBANIA? Juncker launches big push for full membership, [www.express.co.uk](http://www.express.co.uk), 4 korrik.



dhe shpesh herë ka ndërmarrë masa drastike duke bojkotuar procesin, kjo si mënyrën e vetme e imponimit të saj ndaj qëndrimeve arrogante të pozitës. Një rol vendimtar në ndërmjetësimin dhe arritjen e marrëveshjes midis palëve e kanë luajtur aktorët evropian, siç ishte rasti i ndërhyrjes së Parlamentit Evropian në vitin 2010 për t'i dhënë fund bojkotit të Partisë Socialiste, apo në vitin 2014 për t'i dhënë fund bojkotit pesë-mujor të Parlamentit nga Partia Demokratike.

Si pozita ashtu edhe opozita bëjnë kujdes në prononcimet e tyre dhe akuzojnë njëra-tjetrën për mos realizimin e agjendës evropiane, kjo sepse asnjëra prej tyre nuk dëshiron që të identifikohet si forcë frenuese e përparimit të vendit në rrugën e integritit evropian përpara elektoratit, shumica e të cilëve janë pro-evropianë. Në retorikën e elitës politike të partisë në pushtet, gjithmonë dështimi i ecurisë në marrëdhëniet e avancimit të vendit për integrimin evropian, është evidentuar roli frenues i opozitës. Në daljet publike Ministrja e atëhershme e Integritit Evropian, znj. Bregu, është shprehur se *'Shqipëria ka humbur dy vjet duke mos marrë statusin e kandidatit. Ne kemi dëmtuar veten. Mjaft me luftimet e brendshme të dy viteve të fundit! Megjithëse kemi bërë kompromis, nuk kemi bërë mjaftueshëm'*.<sup>14</sup> Në të njëjtën linjë, por me role të ndryshuar, edhe kryeministri aktual i Shqipërisë z. Rama është shprehur në daljet e tij publike se për arritjen sa më

shpejt të objektivit të integritit të vendit kërkohet bashkëpunimi me opozitën, por që nuk ka gjetur mbështetjen e duhur.<sup>15</sup>

#### PROGRES KONSTANT I ÇALË:

**PËRMBUSHJA E STANDARDEVE EVROPIAN**  
Në vlerësimin e ecurisë së Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE, çështja nuk është vetëm kur por edhe sa dhe deri në çfarë shkalle janë përmbushur standardet evropiane. Thënë ndryshe, në ç'masë Shqipëria ka bërë progres në adaptimin dhe zbatimin e politikave të BE-së.

Në mënyrë që të japim një vlerësim sistematik dhe gjithëpërfshirës të shkallës së përmbushjes së standardeve evropiane në vend me *acquis*-në e BE-së, do ti referohemi raporteve të progresit të Komisionit Evropian të cilat monitorojnë çdo vit në mënyrë të detajuar ecurinë në përmbushjen e kushteve të Kopenhagen-it. Metodologjikisht, progres raportet kanë një formë të standardizuar dhe rigorozë, ato ndjekin kryesisht të njëjtën strukturë si në vitet e mëparshme. Vlerësimi i progres raporteve vjetore ofrojnë një burim shumë të dobishëm analizimi pasi ato prezantojnë të dhëna të përmbledhura, sistematike bazuar në një numër të madh burimesh. Raportet janë hartuar nga Komisioni Evropian në bazë të informacioneve të grumbulluara nga shumë burime, përfshi informacionet dhe kontributet nga delegacionet e BE-së, qeveritë e shteteve anëtare dhe vendeve potencialisht shtete anëtare, raportet e Parlamentit Evropian

<sup>14</sup> Ish-Ministrja e Integritit Evropian, znj. Majlinda Bregu, citimi marrë nga: European Policy Center (2012) 'To compromise or not to compromise? Albanian politicians between outdated dilemmas and European imperatives', report, Shtator.

<sup>15</sup> "Në katër vjet nga sot, Shqipëria duhet të jetë shumë më afër Bashkimit Evropian se sa ç'është sot, dhe është dhe do të jetë përgjegjësia ime një

përgjegjësi që nuk më tremb përkundrazi më nxit...I kam lutur kundërshtarët tanë për një pakt për të punuar së bashku për këtë qëllim dhe për disa objektiva me interes kombëtar." Shih komunikimin javor të Kryeministrit datë 28 tetor 2017, ora 17.20. <https://www.facebook.com/edirama.al/videos/10155264880831523/>

dhe vlerësimet e bëra nga organizata të ndryshme ndërkombëtare (në veçanti Këshilli i Evropës, OSBE-ja, Institucionet Financiare Ndërkombëtare) dhe organizatat jo-qeveritare. Raportet e Komisionit janë një burim i mirë të dhënash për të vlerësuar në mënyrë cilësore ndryshimet në pothuajse të gjithë sektorët e politikave publike si në aspektin legjislativ (adoptimin e legjislacionit dhe politikave zyrtare të BE-së), ashtu edhe aspektin e zbatimit praktik të tyre.<sup>16</sup> Progresi matet mbi bazën e institucioneve të ngritura apo të azhurnuara, vendimeve të marra, ligjeve të miratuara dhe masave të zbatuara: si rregull, ligjet apo masat që janë në përgatitje e sipër apo që presin miratimin e parlamentit nuk janë marrë parasysh si të zbatuara. Kështu do të mund të japim një vlerësim cilësor kohor nëse është arritur progres ose jo, apo nëse progresi i arritur është i rëndësishëm apo i limituar duke iu referuar këtu shprehjeve të veçanta cilësore që raportet përdorin për të përshkruar progresin në lidhje me përmbushjen e kërkesave të BE-së. Fjala 'progres' është shprehja cilësore kyçe.

Për të llogaritur indeksin e performancës së përputhshmërisë do të konsiderojmë *intensitetin* dhe *frequencën* në raportet e vlerësimeve të Komisionit Evropian për performancën (*progresin*) e arritur në secilin sektor të politikave të

*acquis* ose thënë ndryshe në të 33 kapitujt e negociatave për anëtarësim. Për të vendosur në lidhje me *intensitetin* e performancës në secilën fushë të politikave publike (për çdo kapitull të negociatave) do ti referohemi shkallës së përdorur nga vetë Komisioni Evropian. Në raportet e Komisionit Evropian mund të evidentojmë katër vlerësime kryesore<sup>17</sup> për çdo nga fushat e politikave publike në një shkallë rendore nga 'progres i rëndësishëm, i mirë apo i konsiderueshëm' (për ne vlerën 1), thjesht 'progres' (për ne vlerën 0.67), 'progres i pakët, i limituar ose disi' (për ne vlerën 0.33) dhe kur nuk ka 'asnjë progres' (për ne vlerën 0) në një fushë të caktuar të politikave publike. Sipas kësaj shkalë *intensiteti* të progresit ne llogarisim edhe numrin e fushave të politikave publike nën secilën prej kategorive të mësipërme. Për të krijuar një indeks vjetor të performancës së përmbushjes së standardeve evropiane në vend, ne përlllogaritim një mesatare ku shumën e numrit të fushave të politikave publike shumëzuar me koeficientin e *intesitetit* të progresit (sipas vlerave të dhëna nga ne) e pjesëtojmë me numrin e përgjithshëm të politikave publike (ky numër si parim është 33, sa kapitujt e negociatave) të përmendura për vitin specifik. Rezultatet e kësaj përlllogaritje paraqiten në tabelën më poshtë.

<sup>16</sup> Hille, P., dhe C. Knill. (2006) 'It's the bureaucracy, stupid': the implementation of the *acquis communautaire* in EU candidate countries, 1999–2003. *European Union Politics*, fq.541.

<sup>17</sup> Raportet e fundit të Komisionit Evropian me ndryshimin e metodologjisë kanë shtuar një vlerësim të pestë, atë të regresit.




**Tabela 2 Ecuria e përmbushjes së standardeve evropiane në Shqipëri (2005 - 2016)**

Viti	Numri i kapitujve/sectorëve të cilët janë vlerësuar si...				Indeksi i përmbushjes së standardeve evropiane
	<i>Nuk ka asnjë progres</i> 0	<i>Progres i limituar</i> 0.33	<i>Progres</i> 0.67	<i>Progres i rëndësishëm</i> 1	
2005	3	14	4	1	0.38
2006	2	17	6	0	0.39
2007	3	14	6	1	0.40
2008	1	17	12	0	0.46
2009	1	23	10	5	0.49
2010	0	13	12	8	0.62
2011	1	24	8	0	0.40
2012	2	26	4	1	0.37
2013	1	28	3	1	0.37
2014	0	30	3	0	0.36
2015	4	28	0	1	0.31
2016	3	28	0	2	0.34

Burimi: Përlogaritjet janë të autorit. Të dhënat cilësore për statusin e ‘progresit’ të politikave publike në përshtatjen me ato të BE-së janë nxjerrë nga raportet e progresit të Komisionit Evropian. Raportet e progresit janë ndarë në fusha apo kapituj, numri i të cilave ndryshon në varësi të fazës së anëtarësimit (nga 20 për vendet potencialisht kandidate në 33 për vendet në proces bisedimesh për anëtarësim. Indeksi i agreguar i përmbushjes së standardeve evropiane është përlogaritur duke marrë parasysh frekuencën (numrin e fushave të politikave publike) dhe intensitetin (vlerësimi rendor) të ‘progresit’ të raportuar (shuma e numrit të fushave të politikave të shumëzuar me koeficientin e *intensitetit* të progresit sipas vlerave të dhëna, pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të politikave publike të përmendura në vitin përkatës.

**Figura 1: Indeksi i përmbushjes së standardeve evropiane në Shqipëri (2005 - 2016)**

*Progres i Rëndësishëm -*



Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë për periudhën para vitit 2002, fokusoheshin kryesisht në zhvillimet dhe arritjen e kushteve minimale të një demokracie funksionale dhe ekonomisë së lirë të tregut në vend, dhe jo në përafrimin e legjislacionit dhe politikave kombëtare me standardet evropiane. Prandaj, edhe raportet nuk i referoheshin përputhshmërisë me *acquis* e BE-së. Nëse do ti referohemi pikënisjes së Shqipërisë, reformat në lidhje me integrimin evropian kanë qenë larg nivelit të zhvillimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, por krahasuar me vitet më parë ecuria e vendit në vitin 2002 u vlerësua të kish arritur një *progres relative* por të mjaftueshme për të sjellë Shqipërinë në *pragun* për të negociuar MSA-në me BE-në.<sup>18</sup> Përkundrejt këtij progresit relativ formal, kish një ‘mungesë të konsiderueshme kapacitetesh zbatuese’ në ‘pothuajse çdo fushë ku Shqipëria do të merrte detyrime në kuadër të një MSA-së të pritshme’<sup>19</sup>. Gjatë vitit 2003, në aspektin formal të adoptimit vetëm ‘*progres i limituar* është bërë nga Shqipëria’ pasi rekomandimet e përfshira në raportin e Stabilizim-Asociimit të 2002 u shqyrtuan

vetëm pjesërisht.<sup>20</sup> Për më tepër, Shqipërisë ende i mungonte aftësia për të zbatuar dispozitat e një Marrëveshjes të ardhshme ku duke konsideruar ‘shpejtësinë aktuale të zbatimit të reformave, negociatat rrezikonin të zgjateshin dhe të shtyheshin’.<sup>21</sup> Progresi në reforma ka qenë ende i kufizuar në vetëm disa fusha të veçanta në vitin 2004 dhe shumë nga rekomandimet e përfshira në raportin e Stabilizim-Asociimit të 2003 nuk ishin zbatuar siç duhet.<sup>22</sup> Gjatë 2005-së dhe 2006-së, vendi ka bërë *disi progres* drejt përmbushjes së standardeve evropiane, si në miratimin e legjislacionit të ri ashtu edhe në ngritjen e institucioneve të reja.<sup>23</sup> Shqipëria gjatë vitit 2007 dhe 2008 bëri “progres në përafrimin e legjislacionit të saj, politikave dhe kapaciteteve me standardet evropiane”.<sup>24</sup> Por rezultati për zbatimin, ishte pozitiv vetëm për 2007, ndërsa për 2008 raporti paralajmëroi Shqipërinë për nevojën ‘për të rritur përpjekjet e veta në zbatimin’ e ligjeve dhe të politikave të miratuara.<sup>25</sup> Për vitin 2009 dhe për vitin 2010 rezultatet në fusha të ndryshme ndonëse ishin mikse, në përgjithësi Shqipëria arriti të bëjë progres

<sup>18</sup> European Commission (2002) “The Stabilisation and Association process for South East Europe”, First Annual Report Brussels, 03.04.2002, COM(2002) 163 final, fq.15.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> European Commission (2003) “The Stabilisation and Association process for South East Europe”, Second Annual Report, Brussels, 26.3.2003, COM (2003) 139 final, fq.26.

<sup>21</sup> *Po aty*.

<sup>22</sup> European Commission (2004) “The Stabilisation and Association process for South East Europe”, Third Annual Report, Brussels, 30.3.2004, COM(2004) 202 final, fq.34.

<sup>23</sup> MEMO/05/410 “Key findings of the 2005 Progress Reports on Albania, Bosnia and Herzegovina, Serbia and Montenegro and Kosovo” Brussels, 9 November 2005, fq.2;

MEMO/06/412 “Key findings of the progress reports on Kosovo and the potential candidate countries: Albania, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, Serbia” Brussels, 8 November 2006, fq.2

<sup>24</sup> MEMO/07/446 “Key findings of the progress reports on Kosovo and the potential candidate countries: Albania, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, Serbia” Brussels, 6 November 2007, fq.1;

MEMO/08/672 “Key findings of the progress reports on Albania, Montenegro, Bosnia and Herzegovina, Serbia, and Kosovo” Brussels, 5 November 2008, fq.1.

<sup>25</sup> MEMO/08/672 “Key findings of the progress reports on Albania, Montenegro, Bosnia and Herzegovina, Serbia, and Kosovo” Brussels, 5 November 2008, fq.1.

në përafrimin e legjislacionit dhe politikave me standardet Evropiane.<sup>26</sup> Pavarësisht këtij progresi formal vazhdon nevoja për të rritur përpjekjet për implementimin e këtyre ligjeve dhe politikave.<sup>27</sup> Pas vitit 2010, ka një përkeqësim në lidhje me nivelin e përmbushjes së standardeve evropiane. Në lidhje me shkallën e përparimit vjetor, Shqipëria gjatë viteve 2010-2016, ka pasur për shumicën e sektorëve vetëm disa përparime të pjesshme dhe përpjekjet drejt përafrimit me legjislacionin e BE-së janë të kufizuara. Progres është arritur në 68 raste, kurse progres i rëndësishëm është arritur në vetëm 20 raste. Në 21 raste të tjera, nuk ka aspak progres. Në lidhje me nivelin e përgatitjes për të 33 kapitujt, Komisioni Evropian në opinionin e nëntorit të vitit 2010 vlerësoi se në rastin e Shqipërisë: 8 kapituj ishin shumë të lehtë për tu përafruar me legjislacionin e BE-së, 12 kapituj u vlerësuan të lehtë për tu përafruar, ndërkohë që për 12 kapituj të tjerë kërkoheshin përpjekje shtesë për t'u përafruar pasi vlerësoheshin si të vështirë, dhe kapitulli për ambientin ishte vlerësuar si shumë i vështirë për t'u përafruar me legjislacionin e BE-së.<sup>28</sup> Ndërkohë që në raportin e fundit të vitit 2016, Komisioni Evropian vlerëson se: 5 kapituj janë në fazë të hershme, për 11 kapituj është arritur vetëm një farë niveli përparimi, ndërkohë që për 16 kapituj përgatitja është e moderuar dhe vetëm 1 kapitull ka nivel të mirë përgatitjeje (kapitulli për politikën e jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes).<sup>29</sup>

Në rastin e Shqipërisë, për sa i përket përmbushjes së standardeve evropiane, si në aspektin e miratimit të politikave dhe ligjeve ashtu edhe në zbatimin e tyre, duke u bazuar në të dhënat e nxjerra nga progres raportet, mund të vërehet një ecuri të limituar konstante me vetëm një hov në vitin 2010 ku rezultatet e adoptimit përmirësohen disi, trend ky që vazhdon të ulet përsëri. Sipas kësaj parashprese dhe në bazë të të dhënave të nxjerra nga raportet e Komisionit, Shqipëria ka progres të limituar në përmbushjen e standardeve evropiane.

#### ARSYET E MOS AVANCIMIT ME REFORMAT PËR ANËTARËSIM

Kjo performancë e dobët e Shqipërisë, me një progres të çalë, duhet të na bëjnë të mendojmë dhe hulumtojmë më tej se cilët janë faktorët kryesor që shpjegojnë një performancë kaq të dobët të Shqipërisë. Pa dashur të bëjmë një analizë të hollësishme dhe metodologjike, e cila duhet të jetë një hulumtim më vete, në këtë dokument politikash ne do të propozojmë disa nga argumentet të cilët janë të rëndësishëm për të kuptuar pse performanca e Shqipërisë ka këtë trend negativ.

Progresi i Shqipërisë ka marrë një shtytës rreth vitit 2010, momenti i procesit të liberalizimit të vizave me vendet e Ballkanit Perëndimor. Dialogu me BE-në për të hequr regjimin e vizave në vendet e Ballkanit Perëndimor filloi në pranverën e vitit 2008 dhe në rastin e Shqipërisë në fund të vitit 2010, BE-ja vlerësoi se Shqipëria i

<sup>26</sup> MEMO/09/450 "Key findings of the progress reports on Albania, Montenegro, Bosnia and Herzegovina, Serbia, and Kosovo" Brussels, 14 October 2009, fq.2;

MEMO/10/553 "Key findings of the Opinion on Albania", Brussels, 9 Nëntor 2010, fq.2.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> European Commission (2010) Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union, Brussels, 9.11. 2010, COM(2010) 680, fq.9-10

<sup>29</sup> Shih vlerësimet për çdo kapitull: European Commission (2016) Albania 2016 Report, COM(2016) 715 final

kishte përmbushur me sukses kushtet për liberalizimin e vizave.<sup>30</sup> Shumë nga kriteret për liberalizimin e vizave ishin nën-sektorë të ndryshëm të politikave publike që lidheshin me çështje të sigurisë, migrimit, rendi publik, marrëdhëniet me jashtë apo të drejtat e njeriut. Kjo shpjegon pse i gjithë procesi i liberalizimit të vizave është i lidhur ngushtë me një përparim të lehtë në përmbushjen e standardeve evropiane në atë periudhë. Liberalizimi i vizave me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë, në vitin 2009, rriti kredibilitetin e procesit edhe për Shqipërinë duke krijuar pritshmërinë se nëse përparohet me përmbushjen e kushteve të BE-së do të mund të merret 'shpërblimi'.

Ndërsa në rastet e tjera, progresi i limituar mund të kuptohet për shkak të pengesave të brendshme, p.sh. jo vetëm mos-bashkëpunimi politik si pengesë e miratimit të legjislacionit por edhe pengesat më domethënëse që janë të një karakteri administrative, ku mungesa e efikasitetit të administratës publike dhe burimeve financiare ose shpërndarjes jo e barabartë e kapaciteteve njerëzore, mungesa e një praktike të konsoliduar të konsultimit me grupet e interesit për draftimin e legjislacionit specifik, si dhe pamundësia për të aplikuar mekanizma të shëndoshë të planifikimit dhe të vlerësimit real të cilat reflektojnë sidomos në probleme të zbatimit të dobët të politikave të BE-së.<sup>31</sup> Për më tepër, pas vitit 2014 në asnjë nga sektorët nuk ka pasur progres, dhe ecuria është ngadalësuar më tej kjo pasi edhe për shkak të politikave të cilat marrin prioritet

në momente të caktuara. Dy vitet e fundit reforma në drejtësi ka qenë prioriteti primar dhe i vetëm i qeverisë, e cila ndoshta ka ndikuar negativisht në dëm të progresit të politikave të tjera.

## KONKLUZIONE

Në terma të përgjithshme, Shqipëria ka arritur transformime rrënjësore që prej vitit 2000 kur Bashkimi Evropian lancoi politikën e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor dhe e njohu Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit si shtete kandidate potenciale. Këto transformime janë më të kuptimta nëse konsiderojmë stadin fillestar në të cilën Shqipëria e filloi procesin e integritit evropian. Pas më shumë se 15 vitesh, vendi jo vetëm që është demokratizuar dhe ka arritur një stabilitet ekonomik por edhe ka përparuar gjithnjë e më shumë në lidhje me arritjen e disa standardeve evropiane dhe procesin e anëtarësimit. Megjithatë Shqipëria, në parim e ka perspektivën e integritit, kredibiliteti i anëtarësimit është më i largët sesa ai i disa prej vendeve të rajonit. Kjo indirekt evidentohet edhe në komunikimin e fundit të presidentit Junker mbi programin e punës të Komisionit, ku vetëm Serbia dhe Mali i Zi, përmenden si vende favorit për një anëtarësim të mundshëm në vitin 2025.<sup>32</sup> Në rastin e grupit të vendeve me anëtarësim të ngadaltë, kostot e përmbushjes së kushteve të BE-së janë gjithashtu të larta, pasi në disa raste ato prekin çështje të ndjeshme politike, ose sepse kapaciteti administrativ dhe financiar i vendit është i limituar. Duke pasur parasysh këtë situatë përgjithësisht të pafavorshme, vonesa në rrugën e

<sup>30</sup> Për më tepër shih: ESI project on Viza Liberalization

<http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=342>

<sup>31</sup> Hajdini, Bojana dhe Gentjan Skara (2017) Lost in Implementation: EU Law Application in Albanian Legal System, Journal of Legal Studies, 19 (33)

<sup>32</sup> European Commission (2017) State of the Union 2017. Letter of intent to the president of the European Parliament Antonio Tajani and the prime minister of Estonia Jüri Ratas, Brussels, 13 Shtator, fq.10.

anëtarësimit mund të sjelli efekte negative në Evropianizimin e vendit.<sup>33</sup>

Nga analiza e këtij dokumenti politikash vërejmë se ecuria e Shqipërisë drejt anëtarësimit është jo vetëm e avashtë por edhe e çalë.

Nëse vendi vazhdon të zvarritë reformat thelbësore të anëtarësimit, Shqipëria do ti largohet BE-së dhe do të mbetet gjithnjë e më shumë në zonën e stanjacionit të procesit të integritit evropian, që tashmë përfshin vende problematike të rajonit.<sup>34</sup> Kjo situatë ka bërë që Shqipëria të mbetet mbrapa, jo në grupin e vendeve të rajonit të cilat kanë përparuar drejt anëtarësimit, por përkundrazi të radhitet me vendet më problematike si Bosnja dhe Kosova. Stanjacioni, - ose progresi konstant i limituar, - në përmbushjen e kushteve të anëtarësimit është problematik pasi ka rrezik që të degjenerojë në një regres të plotë në terma afat-gjatë. Tensionet dhe konfliktet politik në të gjitha nivelet e shoqërisë shqiptare, midis lidhshimit, partive politike, shoqërisë civile dhe medias parandalon bashkëpunimin efektiv mes palëve dhe për rrjedhojë çdo progres të shpejtë drejt zbatimit të reformave të nevojshme për anëtarësimin e vendit në

BE.<sup>35</sup> Polarizimi dhe mos-bashkëpunimi është pengesa kryesore drejt anëtarësimit në BE e cila duhet të tejkalohet pasi ecuria e shpejtë dhe cilësore drejt rrugës së anëtarësimit mund të arrihet vetëm nëpërmjet vullnetit politik të elitës shqiptare, rritjen e kapacitetit administrativ si dhe paraqitjen e rezultateve konkrete në reformat e ndërmarra.

Nga ana tjetër, rezulton se Shqipëria ka më shumë gjasa të përputhi legjislacionin dhe politikat e veta me standardet evropiane nëse BE-ja ofron 'shpërblime' të ndërmjetme për vendin në fusha specifike të politikave publike si p.sh. liberalizimi i vizave në rastin e pajtueshmërisë me kushtet në sektorin e drejtësisë dhe punëve të brendshme.<sup>36</sup> Mbajtja e një presioni mbi çështje kyçe dhe ofrimi i avantazheve nga ana tjetër, do ta legjitimojnë procesin dhe rezultatin, pasi kjo do të shihet si një mënyrë reale për të kompensuar besueshmërinë e ulët të anëtarësimit të shpejtë.<sup>37</sup> Kjo analizë e nivelit aktual të pajtueshmërisë së vendit me kushtet e anëtarësimit si dhe shkaqeve të saj mund të na ndihmojë për të kuptuar procesin si dhe inkurajuar politikëbërësit për të formuluar masa konkrete të cilat të synojnë të adresojnë arsyet reale të kësaj performance të dobët. Shqipëria duhet të kapi momentin dhe të ndërtojë mbi

<sup>33</sup> Analistët shohin një rrezik potencial të heshtur të procesit të integritit të Ballkanit Perëndimor të ndarë në grupe sipas perspektivës së tyre reale të anëtarësimit. Ndërsa një grup vendesh nga Ballkani Perëndimor ecën përpara, duke iu përmbajtur procesit gradual të anëtarësimit, perspektivat e grupit të vendeve të ngadalta kërcënohet seriozisht për shumë arsye. Shih: Balkans in Europe Policy Advisory Group (2014) "The Unfulfilled Promise: Completing the Balkan Enlargement", Policy Paper, Maj, fq. 12.

<sup>34</sup> Stratulat, Corina dhe Gjergji Vurmo (2012), Opportunity knocks: can the EU help Albania to help itself?, Policy Brief, European Policy Centre, Mars.

<sup>35</sup> Stern, Ulrike dhe Sarah Wohlfeld (2012), *Albania's Long Road into the European Union: Internal political power struggle blocks central reforms*, DGAP, Berlin.

<sup>36</sup> Për më tepër rreth këtij argumenti në gjithë Ballkanin Perëndimor shih: Renner, Stephan, dhe Florian Trauner (2009) "Creeping EU Membership in South-east Europe: The Dynamics of EU Rule Transfer to the Western Balkans". *Journal of European Integration* 31 (4): 449-465.

<sup>37</sup> Jano, Dorian (2016) "Compliance with EU Legislation in the Pre-Accession Countries of South East Europe (2005–2011): A Fuzzy-set Qualitative Comparative Analysis". *Journal of European Integration*, fq.19.



praktikat e mira. Në këtë kontekst, është thelbësore për të nxitur një debati publik konstruktive dhe të mirë informuar mbi situatën reale të vendit si dhe gjasat për të përmbushur kushtet e anëtarësimit pasi ambicjet politike në vend nuk mund të tejkalojnë realitetin.

## REFERENCA

- Balkan Insight (2009) 'EU Welcomes Albania's Application: European Commission has welcomed Albania's application for EU membership'. Prill.
- Balkans in Europe Policy Advisory Group (2014) "The Unfulfilled Promise: Completing the Balkan Enlargement", Policy Paper, Maj.
- Bertelsmann Stiftung's Transformation Index (BTI) <https://www.bti-project.org/>
- Böhmelt, Tobias dhe Tina Freyburg (2017) "Forecasting candidate states' compliance with EU accession rules, 2017–2050", Journal of European Public Policy.
- Dimitrova, Antoaneta L. (2016) The EU's Evolving Enlargement Strategies: Does Tougher Conditionality Open the Door for Further Enlargement?, No. 30, Qershor, "Maximizing the integration capacity of the European Union: Lessons of and prospects for enlargement and beyond" (MAXCAP).
- ESI project on Viza Liberalization <http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=342>
- European Commission (2002) "The Stabilisation and Association process for South East Europe", First Annual Report Brussels, 03.04.2002, COM (2002) 163 final.
- European Commission (2003) "The Stabilisation and Association process for South East Europe", Second Annual Report, Brussels, 26.3.2003, COM (2003) 139 final.
- European Commission (2004) "The Stabilisation and Association process for South East Europe", Third Annual Report, Brussels, 30.3.2004, COM (2004) 202 final.
- European Commission (2010) Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union, Brussels, 9.11. 2010, COM (2010) 680.
- European Commission (2016) "2016 Enlargement Package: Credible enlargement process key to driving transformation and anchoring stability in Southeast Europe", Press release, Bruksel, Nëntor.
- European Commission (2016) Albania 2016 Report, Brussels, 9.11.2016, SWD(2016) 364 final.
- European Commission (2016) Albania 2016 Report, COM(2016) 715 final
- European Commission (2017) State of the Union 2017. Letter of intent to the president of the European Parliament Antonio Tajani and the prime minister of Estonia Jüri Ratas, Brussels, 13 Shtator
- European Policy Center (2012) 'To compromise or not to compromise? Albanian politicians between outdated dilemmas and European imperatives', report, Shtator.
- Hajdini, Bojana dhe Gentjan Skara (2017) Lost in Implementation: EU Law Application in Albanian Legal System, Journal of Legal Studies, 19 (33)
- Hille, Peter dhe Christoph Knill. (2006) 'It's the bureaucracy, stupid': the implementation of the acquis communautaire in EU candidate countries, 1999–2003. European Union Politics.

Jano, Dorian (2016) "Compliance with EU Legislation in the Pre-Accession Countries of South East Europe (2005–2011): A Fuzzy-set Qualitative Comparative Analysis". *Journal of European Integration*.

Jay, Tom (2016) The race for EU membership: Enlargement is not high on the EU's agenda, but that isn't stopping its would-be members, *POLITICON*, Dhjetor.

Komunikimin javor i Kryeministrit, datë 28 tetor 2017, ora 17.20. <https://www.facebook.com/edirama.al/videos/10155264880831523/>

Marcillacq, Florent (2015) "EU Enlargement in troubled times? Adapting to new realities and drawing lessons from democratisation failures", *ÖGfE Policy Brief 39*, Vienna.

MEMO/05/410 "Key findings of the 2005 Progress Reports on Albania, Bosnia and Herzegovina, Serbia and Montenegro and Kosovo" Brussels, 9 November 2005.

MEMO/06/412 "Key findings of the progress reports on Kosovo and the potential candidate countries: Albania, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, Serbia" Brussels, 8 November 2006.

MEMO/07/446 "Key findings of the progress reports on Kosovo and the potential candidate countries: Albania, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, Serbia" Brussels, 6 November 2007.

MEMO/08/672 "Key findings of the progress reports on Albania, Montenegro, Bosnia and Herzegovina, Serbia, and Kosovo" Brussels, 5 November 2008.

MEMO/08/672 "Key findings of the progress reports on Albania, Montenegro,

Bosnia and Herzegovina, Serbia, and Kosovo" Brussels, 5 November 2008.

MEMO/09/450 "Key findings of the progress reports on Albania, Montenegro, Bosnia and Herzegovina, Serbia, and Kosovo" Brussels, 14 October 2009.

MEMO/10/553 "Key findings of the Opinion on Albania", Brussels, 9 Nëntor 2010.

Oliphant, Vicki (2017) EU to replace Britain with ALBANIA? Juncker launches big push for full membership, [www.express.co.uk](http://www.express.co.uk).

Renner, Stephan, dhe Florian Trauner (2009) "Creeping EU Membership in South-east Europe: The Dynamics of EU Rule Transfer to the Western Balkans". *Journal of European Integration* 31 (4).

Rupnik, Jacques (ed.) (2011) *The Western Balkans and the EU: 'the hour of Europe'*, Chaillot Paper, EU Institute for Security Studies, Paris, Qershor.

Stern, Ulrike dhe Sarah Wohlfeld (2012), *Albania's Long Road into the European Union: Internal political power struggle blocks central reforms*, DGAP, Berlin.

Stratulat, Corina dhe Gjergji Vurmo (2012), *Opportunity knocks: can the EU help Albania to help itself?* Policy Brief, European Policy Centre, Mars.

Vurmo, Gjergji (2008) "Relations of Albania with the EU", Paper prepared in the Framework of the Project: 'Integration Perspectives and Synergic Effects of European Transformation in the Countries Targeted by EU Enlargement and Neighborhood Policies', Center for EU Enlargement Studies, Budapest.